



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXXVI-të (tridhjetegjashtë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 01 gusht 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;15

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë:

znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, znj.Fikmete Qurkolli, z.Selver Rama, kurse mungoi z.Demokrat Hodolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Shefqet Ismajli nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Arianita Beqa-Rraci përfaqësuese e UNMIK; Zita Rasztik përfaqësuese të KFOR-LMT.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj fillimisht falënderoj përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe UNMIK-ut për prezencën e tyre në këtë mbledhje.

Në vazhdim lexon rendin e ditës dhe njëkohësisht pyet nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, por meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedhi në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete të mbajtura më: 09 qershor 2025 dhe 04 korrik 2025

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi dy procesverbale nga dy mbledhjet e kaluara të Komitetit për Komunitete, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth tyre, nëse jo i hedh në votim këto dy procesverbale sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, miratohen dy procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete sipas materialit përkatës të dërguar për këtë pikë të rendit të ditës

2. Shqyrtimi i realizimit të Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për gjashtëmujorin e parë të vitit dhe koordinimi i veprimeve për periudhën vijuese të këtij viti.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj teme, theksoi, gjatë këtij gjashtëmujori jemi mundua t'i përmbahemi Planit të Punës së këtij Komiteti për vitin 2025, për çka një falënderim i veçantë shkon për zyrtarin e Zyrës ligjore Enis Sheholli, dhe shefin e ZKKK Liman Zeqiri të cilët ndoshta nuk na kanë lënë të dalim jashtë këtij Plani.

Gjatë këtij gjashtëmujori kemi bërë vizita në shkollat “Naim Frashëri”, “Shaban Shala”, “Dr.Ibrahim Rugova”, vizita nga të cilat kemi parë nga afër dhe në takime me drejtorët e shkollave jemi informuar për nxënësit e komuniteteve jo shumicë, mësimin e tyre, vijim në proceset mësimore, por edhe për çështje tjera që ndërlidhen me ata nxënës siç është një ndër to edhe braktisja e shkollimit e që për fat të mirë në Komunën tonë nuk kemi braktisje të shkollimit nga nxënësit e komunitetit jo shumicë në këtë periudhë që po diskutojmë, por që tentime të ndryshme për ta braktisur ka pas, mirëpo falë drejtorëve të shkollave por edhe komisionit për parandalimin e braktisjes së shkollimit, janë realizuar planet e tyre dhe nuk kemi ndonjë rast.

Gjithashtu në shkollat e cekura, të gjithë nxënësit e komunitetit jo shumicë janë regjistruar me kohë e që në këtë aspekt problemi paksa ka qenë te Klasa e I-r dhe parashkollorë, por dua t'ju them se kjo është falë edhe vetëdijesimit të prindërve për çka kemi punuar shumë me vit të tëra, por që edhe ne gjatë kësaj kohe kemi punuar në disa raste për t'i regjistruar ata nxënës në Klasë të I-rë dhe janë regjistruar të gjithë e që ka qenë ky si një prej shqetësimeve në të kaluarën, dhe në këtë aspekt çka është më e mira se nuk kemi raste të vajzave që nuk janë të regjistruara e që në të kaluarën ka qenë ky si një prej shqetësimeve sa i përket shkollimit të nxënësve të komuniteteve jo shumicë, kryesisht në Klasë të I-rë. Një gjë të tillë na është thënë nga drejtorët e shkollave të cekura në takime nga vizitat e parapara në Planin e punës për këtë vit.

Në vazhdim kanë mbetur të vizitojmë edhe shkollat në fshatrat Sfeçël, Batllavë dhe Orllan e që mendojmë se në muajin shtatorë do t'i vizitojmë edhe këto shkolla dhe të shohim nga afër çështjen e nxënësve të komuniteteve jo shumicë që vijnë në procesin mësimor në ato shkolla por edhe regjistrimet e reja, aq më mirë kur në atë kohë është edhe fillimi i vitit të ri shkollorë e që mendoj se do të informohemi më në detaje dhe do të marrim shënime, pra këtë e planifikojmë.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi vizituar edhe lagjet ku jetojnë komuniteti Rom, Ashakli dhe Egjptas në rrugën “Xhafer Meta”, në rrugën “Ali Ajeti”.

Në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rrugën “Xhafer Meta” i kemi marrë të gjitha shqetësimet e banorëve aty dhe që jemi munduar që disa prej tyre t'i diskutojmë edhe në këtë Komitet për Komunitete siç kanë qenë kryesisht ndërtimi dhe renovimi i shtëpive siç është edhe po ashtu në rrugën “Ali Ajeti” si shqetësim apo kërkesë, mirëpo në këtë lagje problem është mungesa e ujit dhe rrjeti i ujësjellësit e që jemi ballafaquar bukur shumë me këtë problem, por që kohën e fundit edhe ky problem u zgjidh besoj sepse kompania që do ta rregulloj ka qenë dhe ka bërë matjet dhe shenjëzimet se ku do të vendoset gypi ri, enda nuk ka filluar por meqë kanë lëvizë diçka besoj se është veç fillimi i realizimit të atij projekti.

Gjithashtu në disa raste gjatë këtij gjashtëmujori kemi paraqitur tema për të cilat edhe janë ftuar drejtorët e Drejtorive të na paraqesin informata, përgjigje dhe sqarimet e nevojshme për çështje të ndryshme që ndërlidhen kryesisht me komunitetin jo shumicë, ftesa për të cilat pothuajse të gjithë u janë përgjigj dhe kanë qenë të pranishëm në ato mbledhje duke dhënë kontributin e vet.

Sa për informimin e juaj, z.Liman Zeqiri i posedon të gjitha fotografitë, kërkesat dhe të dhënat nga ato vizita në lagjet e cekura, kjo për arsye se në rast e ndokush i kërkon të jenë të gatshme.

Po ashtu e falënderoj zotëri Zeqirin i cili na ka ndihmuar shumë me kompletimin e dokumentacioneve sa i përket konkurseve për renovime dhe ndërtime të shtëpive ku nga Komuna e Podujevës në atë periudhë ka shkuar një numër i madh i kërkesave të plotësuara në Ministri por q asnjë nuk është kthyer pozitivisht.

Pra kjo ishte shkurtimisht rreth kësaj pike të rendit të ditës nga ana ime si Kryesues i këtij Komiteti, mirëpo urdhëroni nëse ndokush nga ju dëshiron fjalën, nëse j atëherë e konsiderojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, dhe kalojmë në pikën e radhës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës

3. Informatë e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit në mes Komunës së Podujevës dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim IOM, për vazhdimin e projekteve për Komunitetin jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës prezent kemi shefin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, i cili sigurish se do të na informon rreth kësaj pike.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK-Podujevë, theksoi, fillimisht ju shpreh respekt të gjithë anëtarëve të këtij Komiteti, qoftë nga asambleja komunale qoftë nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, e po ashtu përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, KFOR-it si dhe zonjën e respektuar përfaqësuese e misioni të Kombeve të Bashkuara - UNMIK, mediat dhe gjithë çka janë prezent.

Po ashtu së pari falënderoj Kryesuesin e këtij Komiteti për punën, motivin dhe angazhimin e tij për komunitetin jo shumicë në Komunën tonë që e keni si detyrë parësore ju si përfaqësues të komuniteteve sepse çdo herë ke qenë i gatshëm dhe ke punuar në interes të komuniteteve.

Ato që u cekën nga Kryesuesi paraprakisht janë realitet dhe çdo herë keni pasë dhe keni bashkëpunimin dhe koordinimin të jashtëzakonshëm dhe të shkëlqyeshëm me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim si brenda institucioneve lokale përfshirë edhe të gjitha Drejtoritë përkatëse që merren me këto çështje si dhe Kryetarin dhe Nënkryetaren e Komunës.

Sa i përket Memorandumit të Mirëkuptimit me IOM, e vlerësoj shumë bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre sepse siç dihet në Kosovë janë 38 komuna dhe kjo Organizatë në mesin e 10 komunave përfituese na ka zgjedh edhe neve Podujevën si Komunë sepse kemi një diversitet të mirë dhe të shkëlqyeshëm ngase nuk ka pasë asnjë aksident, ekses apo ndonjë konflikt verbal ta quaj ashtu, por ka qenë bashkëjetesë e sinqertë mes komuniteteve për çka duhet të përgëzohet komunitete shumicë por edhe ai jo shumicë për sjelljet, kulturën, edukatën, punën dhe për këtë bashkëjetesë mes vete që kemi e që disa herë e kamë potencuar se unë personalisht e kam heq termin komunitet duke e zëvendësuar me qytetarë të përbashkët që bashkëjetojmë e vite të tëra e ndoshta edhe me shekuj në Komunën tonë.

Kur i referohemi Memorandumit të Mirëkuptimit ne jemi në dijeni se Organizata Ndërkombëtare për Migrim IOM, fokus e ka t'i ndihmoj komunitetet jo shumicë dhe fal komunitetit jo shumicë që janë banorë të Komunës së Podujevës ne kemi përfituar shumë nga kjo organizatë, janë me dhjetëra projekte në kuptimin familjarë që kanë përfituar mjete për vetëpunësim dhe për të hapë mundësi për të punësuar dhe rritur kapacitetin e tyre në punësim me organizim të ndonjë biznesi të vogël nga i cili kanë arritur shumë të zhvillojnë biznesin familjarë. Në këtë vit është ndihmuar një farkëtarë me 4000€ vlerë mjete pune, bëhet fjalë për Faton Behlulin i cili është në lagjen përkatëse në rr."Xhafer Meta" të cilin vazhdimisht e vizitojnë përfaqësues nga kjo Organizatë.

Natyrisht se ka edhe kërkesa tjera të cilat jemi në vazhdim e sipër në mënyrë që t'iu ndihmojmë gjithë atyre që kanë nevojë dhe që ka mundësi të ndihmohen. Dihet se është një përqindje e

vogël e atyre që përfitojnë, mirëpo shumica absolute e mjeteve janë të Bashkësisë Europiane dhe projektet implementohen nga IOM, dhe duke e falënderuar këtë Organizatë ne më 10.07.2025 ne kemi dërguar mjete pune në vlerë 12,964.00€ në Shkollën e Mesme Teknike, si shkollë profesionale dhe që ato mjete pune janë në funksion të të gjithë nxënësve të asaj shkolle edhe pse donacioni ka ardhur në emër të nxënësve të komuniteteve jo shumicë andaj jo rastësisht e ceka më parë që në emër të komuniteteve jo shumicë përfitues janë të gjithë nxënësit e që janë 7 shkolla të cilat kanë përfutur nga kjo Organizatë. Do të thotë 7 shkolla të jenë përfituese të kabineteve më të mira dhe më moderne në emër të komuniteteve jo shumicë, kjo është kënaqësia më e madhe që ne mund të krenohemi si Komunë, mirëpo ne duke falënderuar edhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ku kemi 30% e projekteve që çdo herë Komuna ka kryer obligimet e marra korrekt në qasje të financave dhe për këtë ajo Organizatë dëshirojnë të vazhdojnë punën me ne edhe në shumë projekte tjera.

Pra kjo është ajo që kam dashtë të arsyetoj dhe të paraqes në Komitetin për Komunitete rolin e IOM dhe angazhimin e juaj personal i nderuar Kryesues dhe të gjithë anëtarëve të Komitetit për Komunitete që të vazhdojmë me punën edhe në të ardhme që t'iu ndihmojmë me shumë e shumë projekte duke i sjellë në Komunën tonë sepse është në interes të të gjithë qytetarëve, duke i falënderuar komunitetet jo shumicë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri për të gjitha këto sqarime dhe njoftime që i bëri, po ashtu falënderoj edhe Organizatën IOM e cila ka përzgjedhur Komunën e Podujevës që të na financoj me projekte të ndryshme që janë të mirëseardhura për komunitetin jo shumicë. Besoj se sukseset nuk kanë munguar dhe mjetet kanë shkuar në vendin e duhur dh aty ku vërtetë ka pasë nevojë siç është rasti i mjeteve në Shkollën Teknike ku janë blerë disa makina nga të cilat janë për “zanatë” e që përfitojnë të gjithë.

Sa i përket projekti që ka përfituar Faton Behluli besoj e është duke bërë punë mjaftë të mirë dhe duke funksionuar shumë mirë, dhe këtë po e them nga vizita që i kamë bërë para disa ditëve ku pash që është duke punuar mjaft mirë, madje pash disa dyer të cilat i kishte punuar për mrekulli dhe të cilat sigurisht që i kishte me porosi, andaj nga kjo shihet se ai projekt ka shkuar në vendin e duhur, kështu që ne duhet të angazhohemi që në të ardhmen të shpërndahen projekte të tilla në ato vende ku vërtetë punohet.

Meqë nuk po vërej që ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj teme, unë edhe njëherë falënderoj parafolësin zotëri Zeqirin dhe Organizatën IOM për punën dhe angazhimin e bërë gjatë kësaj kohe për komunitetin jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës

4. Të ndryshme

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalë, Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0045519/25
Podujevë, 01 gusht 2025**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**